

Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike



osbe Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Një nga detyrat fillestare të Misionit të OSBE-së në Kosovë në vitin 1999, në përputhje me mandatin që kishte për ndërtim të institucioneve, **ishte themelimi i shkollës së policisë që do të trajnonte një shërbim të ri policor shumetnik në Kosovë. Që nga ajo kohë, Misioni i OSBE-së ka pasur rol aktiv në forcimin e sektorit të rendit dhe sigurisë publike në Kosovë, prioritet që vazhdon edhe sot.**

Ky libërth paraqet kontributin e Misionit në themelimin, zhvillimin dhe arritjet kryesore të Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), tani Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP).


Për hartimin e këtij libërthi janë përdorur gjetjet nga raportet vjetore, vlerësimet dhe raportet e brendshme, të prodhuara nga institucionet/organizatat vendore dhe ndërkombëtare, së bashku me burimet e hapura dhe kujtesën institucionale.



FJALORTH

AKSP	Akademia e Kosovës për Siguri Publike
AME	Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave
ASC	Agjencia për Sigurimin e Cilësisë
ECTS	Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive
EUOK	Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetime Penale
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme ¹
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PK	Policia e Kosovës
QKSPEZH	Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SHSHPK	Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

1. Me bashkimin e ministrive në vitin 2020, Ministria e Punëve të Brendshme është bashkuar me Ministrinë e Administratës Publike. Ky libërth do t'i referohet ministrisë së mëparshme, pasi ishte organi ekzekutiv me mandat ligjor në këtë fushë gjatë periudhës së mbuluar në këtë libërth.



OSKINË
në Kosovë

OBRAZOVANJA JAVNE
BEEDNOSTI na Kosovu

PARATHËNIE



Jan Braathu

Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Misioni në Kosovë i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), një nga operacionet më të mëdha të OSBE-së në terren, ka mandat ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë, duke përfshirë promovimin e të drejtave të njeriut dhe respektimin e sundimit të ligjit.

Një nga detyrat e OSBE-së, në kuadër të mandatit të vet në vitin 1999, ishte që të themelonte Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK), e cila filloi trajnimin e kadetëve të rinj të policisë më 6 shtator 1999. Ishte Departamenti i OSBE-së për Edukim dhe Zhvillim të Policisë (tani Departamenti për Rend dhe Siguri Publike), së bashku me Policinë e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që krijuan një shërbim policor të institucionalizuar dhe të qëndrueshëm për Kosovën, i cili përqafon parimet e demokracisë dhe punën policore të orientuar kah komuniteti në një shoqëri shumëetnike.

OSBE-ja mori përsipër rolin drejtues për rekrutimin dhe trajnimin e Shërbimit Policor të Kosovës të sapo themeluar (tani Policia e Kosovës), ndërsa UNMIK-u zhvilloi strukturën dhe menaxhoi organizatën, si dhe siguroi trajnimin në terren. Me propozimin e OSBE-së, Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës më 2006 ndërroi emrin për tu bërë Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), e cila filloi me ofrimin e edukimit për të gjitha institucionet e sigurisë publike, e më pas në vitin 2011 u riemërua si Akademia e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), siç quhet edhe sot.

Fillimisht, kurrikula për trajnimin e policisë u zhvillua bashkë me Programin Ndërkombëtar të Asistencës për Trajnime në Hetime Penale (ICITAP), si dhe kishte një qasje me dy faza, trajnim relativisht të shkurtër në akademi, i cili pasohej me një fazë më të gjatë të trajnimit në terren, për të përmirësuar shkathtësitë dhe njohuritë e të gjithë punonjësve në një nivel më të lartë. Ky program i trajnimit, i cili zgjati deri në vitin 2009, u rishikua vazhdimisht dhe u zhvillua më tej. Zhvillimi gradual i institucionit siç janë infrastruktura, struktura organizative, personeli, buxheti dhe financat, i mundësuan OSBE-së që të adaptojë enkas programet e saj të trajnimit dhe që të angazhojë rreth 150 ekspertë ndërkombëtarë të policisë, të cilët u dërguan nga shtetet pjesëmarrëse. Gjithashtu, deri në këtë kohë, SHPK-ja ishte një organizatë që kishte 13 për qind police gra - përfaqësimi më i lartë i policeve gra në Evropën Juglindore.

Përkundër sfidave për krijimin e një shërbimi policor shumetnik, kurrikulat e trajnimit bazik të zhvilluara për policinë kanë dëshmuar se është e mundshme që të arrihen ndryshime të prekshme në qëndrimet individuale dhe grupore drejt punës policore demokratike. Shërbimi i zbatimit të ligjit është zhvilluar për të ruajtur rendin civil, për të promovuar sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, si dhe për të mbështetur standardet dhe praktikat ndërkombëtare. Çfarë është më e rëndësishmja, Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), shumetnik e rishtas i themeluar, duhej të merrte një rol aktiv në rindërtimin e besimit duke ia zgjatur dorën komunitetit dhe duke krijuar një sistem përmes të cilit do të mund të kuptonin më mirë nevojat e sigurisë dhe shqetësimet e popullatës vendase.

Pas investimeve të mëdha në këtë institucion përgjatë viteve, OSBE-ja filloi me transferimin e kompetencave në vitin 2002, gjë që përfundoi në vitin 2007, kur QKSPEZH-ja u bart në Ministrinë e Punëve të Brendshme si agjenci ekzekutive me punonjës të shërbimit civil. Në vitet pasuese, OSBE-ja mbeti ofruesja e vetme më e madhe ndërkombëtare e trajnimeve për sigurinë publike dhe për agjencitë e zbatimit të ligjit.


Sot, AKSP është institucion i akredituar që mbikëqyret nga Bordi i tij, organ drejtues i cili përbëhet nga Kryeprokurori, Drejtorët e Përgjithshëm të AKSP-së, Policisë së Kosovës, Shërbimit Korrektues të Kosovës, Shërbimit Sprovues të Kosovës, Doganave; shefave ekzekutivë të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave dhe Inspektoratit Policor të Kosovës; së bashku me përfaqësuesit e OSBE-së dhe ICITAP-së, të cilët janë anëtarë të bordit pa të drejtë vote.

Duke punuar më tej për t'i integruar praktikat më të mira ndërkombëtare në programet e mësimnxënies dhe edukimit që fokusohen tek studentët, AKSP-ja është në rrugë të mirë për t'u bërë institucion i vijës së parë të rendit dhe sigurisë publike në rajon. OSBE do të vazhdojë ta mbështesë vizionin e saj për t'u bërë qendër e ekselencës për trajnime dhe edukim për agjencitë e zbatimit të ligjit.



Jan Braathu

Shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë



Community policing

What is community policing?

- A philosophy that focuses on establishing police-public partnerships, where the police representatives, all government agencies and communities actively cooperate in solving problems.
- One of the best ways of preventing international threats.



REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIKA E KOSOVËS
AKADEMIA E DROGËVE
KOSOVSKA AKADEMIJA ZA BORBU PROTIV
KOSOVSKA AKADEMIJA ZA BORBU PROTIV
DROGËVE

Ministry of Internal Affairs
MINISTRI I AFERËVE TË DËNDURA



Further SUPPORT
to PUBLIC SAFETY
EDUCATION in Kosovo

REKABILITIM I BEKIMIT
DHE SIGURIMET
PUBLIKE



PARATHËNIE



Ismail Smakiqi

Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

Ne e çmojmë kontributin e jashtëzakonshëm dhe jemi mirënjohës për Misionin e OSBE-së në Kosovë në mbështetje të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP) dhe ofrimin e edukimit dhe trajnimit për punonjësit e institucioneve të sigurisë publike.

Gjatë këtyre njëzet viteve, që nga themelimi i AKSP-së, OSBE-ja ka mbështetur fuqimisht AKSP-në për arritjen e objektivave të saj. Mbështetja profesionale dhe e dedikuar e OSBE-së ka qenë thelbësore në rrugën e zhvillimit njëzetvjeçar të AKSP-së, duke filluar me Shkollën e Shërbimit Policor të Kosovës e deri tek Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim, si dhe përfundimisht me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, që aktualisht është institucion përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë.

Me rëndësi të veçantë për AKSP-në ka qenë mbështetja e OSBE-së për zhvillimin e legjislacionit primar dhe akteve nënligjore të AKSP-së, krijimin e programeve studimore dhe profesionale, planifikimin e trajnimit, si dhe hartimin e dokumenteve që janë të nevojshme për funksionimin efektiv dhe efikas të institucionit.

Të dashur miq nga OSBE-ja, mbështetja juaj pa dyshim ka kontribuar në profesionalizimin e stafit drejtues dhe të kualifikuar të AKSP-së dhe të agjencive të sigurisë publike, si dhe në forcimin e besimit dhe bashkëpunimit drejt qëllimit të përbashkët të respektimit të drejtave të njeriut, të drejtave të gjitha komuniteteve, sundimit të ligjit dhe sigurisë në Kosovë.

OSBE-ja është krijuesja, udhëheqësja, këshilltarja dhe pa dyshim partnerja më e rëndësishme e AKSP-së.



Prandaj, kjo MIRËNJOHJE E VEÇANTË është nënshkruar dhe i ndahet Misionit të OSBE-së në Kosovë për të shprehur mirënjohjen dhe falënderimin për kontributin e jashtëzakonshëm me rastin e njëzet vjetorit të AKSP-së.

Ismail Smakiqi

Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike

PËRMBLEDHJE

1999

- SHPK-ja u themelua dhe gjenerata e parë e 176 kadetëve të policisë kaluan trajnimin bazë



2000

- Trajnimi bazë u zgjat nga gjashtë në nëntë javë dhe filloi trajnimi i oficerëve korrektues



2001

- Trajnimi bazë u zgjat në 12 javë



2002

- Filloi trajnimi për Policinë Kufitare dhe Doganën



2003

- U rishikua plan-programi për trajnimin bazë 20-javor



2004

- Instruktorët vendorë më të shumtë në numër se instruktorët



2005

- Oficerët e SHPK-së (1,614) mbajtën trajnime në taktikat e menaxhimit të trazirave civile



2006

- SHSHPK u bë Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH)



2007

- OSBE ia dorëzoi autoritetin ekzekutiv QKSPEZH-së



2008

- Nëntë vjet pasi OSBE-ja filloi mandatin e saj, ekzistonte një kornizë ligjore për kompleksin e trajnimeve në Vushtrri (Rregullorja për Themelimin e Bordit të Kosovës për Standardet e Sigurisë Publike dhe Edukimin dhe Udhëzimi Administrativ nr. 2008/3 për zbatimin e Rregullores për QKSPEZH).



2009

- QKSPEZH u bë anëtar vëzhgues i Shoqatës së Kolegjeve Evropiane të Policisë



2010

- Hyn në fuqi Udhëzimi Administrativ për Organizimin dhe Strukturën e Brendshme të QKSPEZH



2011

- Kuvendi i Kosovës miratoi dhe shpalli Ligjin për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), i cili e ngrit AKSP-në në institucion të arsimit të lartë



2012

- U ndryshua Ligji për Policinë dhe shtatë rregulloret e AKSP për funksionalizimin e programeve të arsimit të lartë që u kompletuan dhe miratuan nga qeveria
- Projekti i parë i Binjakëzimit i Bashkimit Evropian (BE) "Edukimi i përmirësuar në sektorin e sigurisë publike dhe rendit në Kosovë" filloi me ekipin zbatues finlandez dhe estonez



2013

- U themelua Bordi i AKSP-së dhe filloi me zhvillimin dhe miratimin e politikave dhe përcaktimin e standardeve minimale profesionale për trajnimin dhe edukimin e agjencive të zbatimit të ligjit



2014

- Filloi programi katërveçar i akredituar i studimeve baçelor në sigurinë publike, i zhvilluar nga Zyra e BE-së në Kosovë për agjencitë e sigurisë publike

BACHELOR I SIGURISË PUBLIKE NË AKSP

Periudha e katërt e Praktikës (25 ECTS)	
Viti 4	Studime të Specializuara (20 ECTS) + Tema e Diplomës (15 ECTS)
Periudha e tretë e Praktikës (20 ECTS)	
Viti 3	Studime të Specializuara (40 ECTS)
Periudha e dytë e Praktikës (20 ECTS)	
Viti 2	Kompetencat e përgjithshme/zakonshme (20 ECTS) dhe Studime të Specializuara (20 ECTS)
Periudha e parë e Praktikës (15 ECTS)	
Viti 1	Studime për Kompetencat e përgjithshme/zakonshme në Siguri Publike (45 ECTS)*

*Përthihet edhe orët e gjuhës

Studime bazë/profesionale + përvojë pune

■ Policia dhe Inspektorati Policor ■ Shërbimi Korrektues ■ Doganat ■ Shërbimet Emergjente dhe Sprovues



2015

- Projekti i dytë i Binjakëzimit i BE "Forcimi i mëtejshëm i Edukimit për Sigurinë Publike në Kosovë" filloi me ekipin zbatues finlandez dhe estonez



2016

- AKSP dhe Akademia e Policisë e Malit të Zi nënshkruan një marrëveshje për të forcuar më tej bashkëpunimin në aspektet e trajnimit dhe edukimit



2017

- U përfunduan dhe standardizuan kurrikulat e bazuara në shkathtësitë e arsimit profesional të AKSP-së për trajnimin bazë të agjencive të sigurisë publike



2018

- Policia e Kosovës dhe Policia e Uellsit Jugor nënshkruan një protokoll bashkëpunimi për forcimin e rolit dhe kontributit të grave në polici



2019

- Më 2019, AKSP-ja festoi Përvjetorin e saj të 20-të, duke shprehur nderim të posaçëm OSBE-së. Zëvendës shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Kilian Wahl, deklaroi gjatë organizimit që "kjo është një mundësi e vlefshme për ne që të bëjmë një përmbledhje të arritjeve të bëra dhe të theksojmë se sa larg ka arritur Akademia që nga viti 1999".



Letra e mirënjohjes, dhuruar Misionit të OSBE-së në Kosovë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së "është shenjë e partneritetit të fuqishëm që është zhvilluar përgjatë 20 viteve të bashkëpunimit".




FAZAT ZHVILLIMORE TË SHKOLLËS SË SHËRBIMIT POLICOR TË KOSOVËS NË VITE

Faza e emergjencës (1999-2001)

Më 6 shtator të vitit 1999, u themelua Shkolla e Shërbimit Policor të Kosovës (SHSHPK) dhe filloi trajnimin themelor policor, të zhvilluar nga OSBE dhe Programi Ndërkombëtar i Asistencës për Trajnime në Hetimet Penale nga Shtetet e Bashkuara (ICITAP), për gjeneratën e parë me 176 kadetë policorë. Gjenerata e parë e kadetëve përbëhej nga 83% shqiptarë të Kosovës, 13% serbë të Kosovës dhe katër (4)% komunitete të tjera të Kosovës, nga të cilat 20% ishin gra.

Programi fillestar i trajnimit bazë përfshinte gjashtë javë mësim në klasë, pasuar nga një program shtesë trajnimi gjashtëjavësh në terren. Në vitin 2000, programi i trajnimit në SHSHPK u zgjerua nga gjashtë në nëntë javë dhe pastaj në vitin 2001 në 12 javë. Në këtë vit, diplomoi gjenerata 16 e kadetëve policorë, duke e çuar numrin e përgjithshëm të policëve të trajnuar në të gjithë Kosovën në 4105.

Përpyqjet e OSBE-së që ishin fokusuar në diversitet rezultuan me praninë e 17% të pjesëtarëve të komuniteteve jo-shqiptare dhe 19% të grave mes të diplomuarve. Për më tepër, deri në vitin 2001, SHSHPK-ja ishte në gjendje që të ofrojë një gamë të plotë të kurseve të trajnimit, përfshirë trajnimin themelor të policisë, trajnimin e specializuar (p.sh. hetimin e krimit, hetimin e rasteve të trafikut rrugor, zhvillim të instruktorit) dhe trajnimin për menaxhim dhe mbikëqyrje për ata që avancoheshin mbi gradën e zyrtarëve të rëndomtë të policisë.



Faza e tranzicionit (2002-2006)

Gjatë kësaj faze, OSBE-ja vazhdoi që të kalojë drejtimin e programit të trajnimit policor nga një sistem kryesisht i drejtuar nga ndërkombëtarët në një sistem që drejtohej kryesisht nga personeli vendas. Deri në fund të vitit 2003, 75% e shërbimeve kryesore në SHSHPK u bartën dhe drejtoheshin nga personeli vendas. Gjithashtu, gjatë kësaj faze, trajnimi u zgjerua edhe më tej deri në 20 javë.

Përveç kësaj, OSBE dhe SHSHPK filluan procesin e shndërrimit të shkollës së policisë në një organizatë të sigurisë publike, duke zgjeruar fushëveprimin e saj, pra për të ofruar trajnime edhe për doganat dhe shërbimin korrektues. Duke qenë se SHSHPK mori emërimin Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH) në përputhje me legjislacionin në fuqi në fund të vitit 2005, ky proces i transformimit përfundoi në vitin 2006, kur QKSPEZH filloi me ofrimin e trajnimit bazë, të specializuar dhe të avancuar për të gjitha agjencitë e sigurisë publike, domethënë Policinë e Kosovës, Shërbimin Korrektues të Kosovës, Shërbimin Sprovues të Kosovës, Doganat, Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave dhe më vonë edhe për Inspektoratin Policor të Kosovës.



Faza e transferimit (2006-2007)

Në këtë fazë, OSBE-ja i transferoi të gjitha përgjegjësitë drejtuese të QKSPEZH-së tek institucionet e përkohshme të Kosovës. Në këtë fazë, numri i instruktorëve lokalë të zbatimit të ligjit, të cilët ofronin kurse për të gjitha agjencitë e sigurisë publike në QKSPEZH, u rrit në 131. SHPK-ja përbëhej nga më shumë se 10% e serbëve të Kosovës dhe më shumë se 13% police gra.

Në të njëjtën kohë, nën drejtimin e OSBE-së, QKSPEZH zhvilloi kurse të mbikëqyrjes së linjës së parë, menaxhimit të mesëm dhe për drejtuesit e lartë për policët e përzgjedhur të SHPK-së të cilët do të emëroheshin në pozita drejtuese. Gjithashtu, deri në fund të kësaj faze, OSBE-ja mbështeti QKSPEZH-në në themelimin e Seksionit të Akreditimit dhe Certifikimit, me qëllim të hartimit të raporteve të vetë-vlerësimit që do të hapnin rrugën për një proces efektiv të akreditimit.



Faza e qëndrueshmërisë (2008-2020)

- 2008**
- Në vitin 2008, QKSPEZH u themelua si agjenci ekzekutive brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme (tani Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike).
 - Hyn në fuqi Rregullorja për krijimin e Bordit të Kosovës për Standardet e Sigurisë Publike dhe Edukimit, dhe Rregullorja për zbatimin e rregullores për QKSPEZH.
 - Mbështetur nga OSBE-ja, ekspertët e Agjencisë Gjermane për Sigurimin e Cilësisë (AQAS) vizituan QKSPEZH-në për vlerësimin e programeve të studimit, personelit dhe aftësive të institucionit dhe potencialin e tij për zhvillimin e një programi të akredituar baçelor për oficerët e zbatimit të ligjit.
 - OSBE-ja filloi me përdorimin e rekomandimeve të paraqitura në raportin e vlerësimit të AQAS, si udhëzues për planifikimin e aktiviteteve për përparimin e zhvillimit të karrierës në agjencitë e zbatimit të ligjit dhe zhvillimin strategjik institucional.
- 2009**
- Në vitin 2009, QKSPEZH u bë anëtare vëzhguese e Shoqatës së Kolegjeve Evropiane të Policisë.
 - Grupi punues i MPB-së filloi hartimin e Ligjit të ri për QKSPEZH.
- 2010**
- Gjatë gjithë vitit 2010, OSBE-ja mbështeti në mënyrë aktive procesin e hartimit të Ligjit të ri për QKSPEZH.
 - OSBE-ja ndihmoi në finalizimin e Udhëzimit Administrativ për Organizimin dhe Strukturën e Brendshme të QKSPEZH.
 - Për të përmirësuar cilësinë e trajnimit për ngasje për kadetët e rinj të policisë dhe anëtarëve të agjencive të sigurisë publike, si dhe për t'iu mundësuar atyre që të drejtojnë automjetin në kushte të pafavorshme rrugore, OSBE i dhuroi QKSPEZH-së një automjet me Sistemin Skid Car (pajisje mekanike e montuar nën automjet që simulon kushtet e rrëshqitshme në rrugë).
- 2011**
- Në vitin 2011, me miratimin e Ligjit të ri nga Kuvendi i Kosovës, QKSPEZH u riemërua në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) si agjenci ekzekutive e MPB-së.
 - OSBE-ja zhvilloi programe të specializuara trajnimi për personelin e AKSP-së dhe të agjencive të sigurisë publike që trajtojnë sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe zbatimin e mjeteve të Bolonjës..
 - OSBE-ja kontribuoi në hartimin e një plani strategjik të zhvillimit për të ndihmuar AKSP-në për të përgatitur një raport institucional të vetë-vlerësimit për arsimin e lartë.

2012

- Në vitin 2012, u krijua Komiteti Drejtues i Projektit të Binjakëzimit të BE-së (OSBE ishte një nga anëtarët) për të mbikëqyr zbatimin e projektit të Binjakëzimit "Edukimi i përmirësuar në sektorin e sigurisë publike dhe rendit në Kosovë".
- Gjatë vitit 2012, në përpjekje për të ndihmuar në plotësimin e kornizës përkatëse ligjore, OSBE-ja kontribuoi në hartimin e shtatë akteve nënligjore për AKSP-në.
- Përgjatë vitit 2012, OSBE-ja dhe Projekti i Binjakëzimit i BE-së trajnuan AKSP-në dhe hartuesit e kurrikulës së sigurisë publike, si dhe ekspertët e lëndëve në hartimin e kurrikulës, me qëllim që t'i kualifikojnë ata për të definuar kompetencat, rezultatet e të nxënit dhe profilet e punës për secilin prej moduleve të specializuara të dorëzuara.

2013

- Në vitin 2013, Bordi i AKSP-së u formua me sukses, si dhe filloi të trajtojë çështjet më të rëndësishme.
- OSBE-ja mbështeti finalizimin e Rregullores për Funkcionimin e Arsimit të Lartë në AKSP, të miratuar më vonë nga qeveria; kontribuoi në hartimin e pesë rregulloreve përkatëse, me qëllim që të rregullojë më tej procedurat e ndërlydhura me AKSP-në.
- OSBE-ja ndihmoi grupin punues të AKSP-së në standardizimin e kurrikulave të finalizuara për titullin baçelor në domenin e shkencave të sigurisë, të miratuara më pas nga anëtarët e Komitetit Drejtues të BE-së.
- OSBE-ja kontribuoi në hartimin e Strategjisë dhe Planit të Zhvillimit të AKSP-së 2014-2018.

2014

- Në vitin 2014, filloi programi katërvjeçar i akredituar i studimeve baçelor në siguri publike për policinë dhe inspektoratin policor, doganat, shërbimin korrektues dhe atë sproves, si dhe menaxhimin e emergjencave.
- OSBE-ja mundësoi një vizitë studimore për delegatët e AKSP-së dhe Policisë së Kosovës në Universitetin e Policisë Gjermane në Muenster, Gjermani.

2015

- Në vitin 2015, OSBE-ja pajisi AKSP-në dhe Fakultetin e saj të sapokrijuar të Sigurisë Publike me mbi 200 asete operative, përfshirë 80 kompjuterë për trajnime në siguri kibernetike dhe kabinetin e informatikës për studentë.
- OSBE-ja mundësoi edhe një vizitë studimore të delegacionit nga Universiteti i Policisë Gjermane të Muenster-it në AKSP dhe PK, me qëllim të përforcimit të bashkëpunimit të tyre në të ardhmen.

- Në vitin 2016, filloi zbatimin edhe projekti i dytë i Binjakëzimit nga BE-ja "Përforcimi i mëtejshëm i Edukimit për Siguri Publike në Kosovë".
- U nënshkrua edhe një Marrëveshje bashkëpunimi midis AKSP-së dhe akademisë policore të Malit të Zi.
- OSBE-ja i dorëzoi AKSP-së mbi 300 libra profesionale për zbatimin e ligjit, me qëllim të pasurimit të bibliotekës së saj.

- Më 2017, OSBE-ja ofroi ekspertizën në procesin e akreditimit dhe verifikimit të kurrikulave me bazë në kompetenca të aftësisë profesionale të AKSP-së, për trajnimet bazë të agjencive të sigurisë publike.
- OSBE-ja përfundoi studimin e fizibilitetit dhe ua dorëzoi atë institucioneve dhe organizatave përkatëse, me synim krijimin e një programi post-diplomik në të ardhmen.
- OSBE-ja mbështeti AKSP-në në zhvillimin e programit bazë të trajnimit për mentorim dhe praktikë për kadetët e agjencive të sigurisë publike.
- OSBE-ja mundësoi një vizitë pune të menaxherëve të lartë të AKSP-së dhe PK-së në Akademinë Kombëtare të Policisë Suedeze dhe Kolegjin Universitar të Policisë Norvegjeze.

- Më 2018, pas një procesi të mundësuar nga OSBE-ja për shkëmbimin e përvojave dhe informacionit, PK-ja dhe Policia e Uellsit Jugor nënshkruan një protokoll bilateral të bashkëpunimit.
- OSBE-ja dorëzoi 30 kompjuterë në AKSP, në përpjekje për ta mbështetur në funksionalizimin e platformës së e-mësimit.
- OSBE-ja mbështeti hartimin e Strategjisë dhe Planit të Zhvillimit të AKSP-së 2019-2022.

- OSBE ka dorëzuar mbi 250 karrige dhe 100 banka shkollore tek AKSP-ja në vitin 2019, duke i ndihmuar Akademisë drejtpërdrejt në plotësimin e kërkesave të hapësirave për pritjen e rreth 800 studentëve të agjencive të sigurisë publike.
- OSBE-ja ka ofruar mbështetje në rishikimin e Planit Vjetor të Trajnimeve të AKSP-së për vitin 2019.
- Më 2019, AKSP-ja festoi Përvjetorin e saj të 20-të, duke shprehur nderim të posaçëm OSBE-së. Zëvendësshefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Kilian Wahl, deklaroi gjatë organizimit që "kjo është një mundësi e vlefshme për ne që të bëjmë një përmbledhje të arritjeve të bëra dhe të theksojmë se sa larg ka arritur Akademia që nga viti 1999". Letra e mirënjohjes, dhuruar Misionit të OSBE-së në Kosovë nga Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së "është shenjë e partneritetit të fuqishëm që është zhvilluar përgjatë 20 viteve të bashkëpunimit".

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi me UNMIK-un

OSBE-ja ka bashkëpunuar me Policinë e UNMIK-ut në themelimin e Shërbimit Policor të Kosovës dhe në kryerjen e kontrolleve të historisë së kandidatëve të parë për kadetë policorë. Përveç këtyre, OSBE-ja dhe UNMIK-u kanë bashkëpunuar edhe në zhvillimin e kornizës ligjore gjithëpërfshirëse për SHSHPK-në dhe QKSPEZH-së, si dhe shërbimin policor në përgjithësi.



"Procesi katër-javor i verifikimit ishte publik dhe transparent, ndërsa kandidatët u vlerësuan për meritat e tyre individuale për të siguruar cilësinë më të mirë të mundshme të zyrtarëve të ardhshëm policorë"

- komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, Sven Frederiksen.

Bashkëpunimi me ICITAP-në

OSBE-ja, së bashku me ICITAP, ka zhvilluar kurrikulën për trajnimet policore, e cila përfshinte një qasje me dy faza, trajnimi relativisht i shkurtër në akademi, pasuar nga një fazë më e gjatë e trajnimit në terren. Si anëtarë pa të drejtë vote, OSBE-ja dhe ICITAP vazhdojnë të bashkëpunojnë në çështje të lidhura me AKSP-në, përfshirë Bordin e AKSP-së, i cili përbëhet nga të gjithë menaxherët e agjencive të zbatimit të ligjit dhe të sigurisë publike, si dhe mbikëqyr punën e AKSP-së.



"SHSHPK-ja është një prej gurthemeleve të demokracisë në Kosovë"

- Z. Steve Bennett, drejtori i parë i SHSHPK-së (nga viti 1999 deri 2007), si dhe menaxher i Programit ICITAP në Kosovë.

Bashkëpunimi me Zyrën e BE-së në Kosovë

OSBE-ja ka gëzuar bashkëpunim të mirë me Zyrën e BE-së në Kosovë në zbatimin e dy projekteve të tyre të binjakëzimit "Përmirësimi i edukimit në Siguri Publike dhe Sektorin e Sigurisë në Kosovë" (2012-2014), si dhe "Mbështetje e mëtejshme për Edukimin e Sigurisë Publike në Kosovë" (2016-2019), të cilat rezultuan me funksionalizimin e Fakultetit të Sigurisë Publike të AKSP-së.



Rendi dhe siguria gjithnjë e më shumë po bëhen çështje globale", [dhe] "vetëm në këtë mënyrë, mund të përballemi me problemet vendore e ndërkombëtare,"

- Z. Antti Häikiö, përfaqësues i Ministrisë së Brendshme të Finlandës, si dhe Drejtues i Projektit nga Shteti Anëtar.

Si anëtare e komitetit drejtues të BE-së, OSBE-ja vazhdimisht ka ofruar mbështetje gjatë zbatimit të projektit të parë dhe atij të dytë të Binjakëzimit të BE-së, veçanërisht duke ndihmuar menaxherët e AKSP-së dhe ata të Projektit të Binjakëzimit që të sigurohen që aktivitetet e ardhshme të projektit të ndërtohen mbi arritjet ekzistuese dhe në adresimin e sfidave të identifikuara:

- Komponenti I "Kontributi në një strukturë të qëndrueshme të aftësisë profesionale për të gjitha Agjencitë e Sigurisë Publike" - OSBE-ja dhe Zyra e BE-së në Kosovë kanë bashkëpunuar në standardizimin e kurrikulës profesionale të AKSP-së, duke e përgatitur atë për verifikim dhe akreditim; kanë zhvilluar doracakun programin e praktikës (programi i trajnimit në terren) për trajnimin bazë profesional të policisë dhe programin baçelor në rend dhe siguri publike;
- Komponenti II "Kontributi në përmirësimin dhe avancimin e mëtejshëm të programit Baçelor të AKSP-së" - në vitin 2016, OSBE-ja kreu një studim të fizibilitetit të studimeve të mundshme të nivelit Master, për të identifikuar nevojat dhe mundësitë e krijimit të programit të nivelit Master në AKSP.

Si rezultat i bashkëpunimit të OSBE-së dhe Zyrës së BE-së në Kosovë përgjatë projektit të Binjakëzimit, si dhe standardizimit të trajnimit bazë dhe programit të studimeve baçelor të AKSP-së, AKSP-ja mori akreditimin institucional, si dhe riakreditimin e programit të tij baçelor në siguri publike.

FAKTE E SHIFRA


- Gjenerata e parë e SHSHPK-së, me 176 kadetë policorë, nga të cilët 39 gra, filloi trajnimet më 6 shtator 1999.
- Kohëzgjatja e kursit bazik të policisë ishte gjashtë javë në vitin 1999, u zgjat në nëntë javë në vitin 2000, në 12 javë në vitin 2001, e përfundimisht në 20 javë në vitin 2004.
- Gjithsej 54 gjenerata, të përbërë nga 10,191 kadetë policorë, kanë kryer kursin bazë profesional të policisë nga viti 1999 e deri më 2019. Nga këta kadetë, 1,458 janë gra dhe 1,594 pjesëtare të komuniteteve jo-shumicë.
- Me propozimin e OSBE-së, Akademia ndërroi titullin në vitin 2006, duke u quajtur Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim (QKSPEZH), e cila filloi ofrimin e trajnimeve bazë, të specializuara dhe të avancuara për të gjitha agjencitë e sigurisë publike.
- OSBE-ja kishte mandat të plotë ekzekutiv mbi SHSHPK-në deri në vitin 2006.

- Në tetor të vitit 2014, filloi programi katërvjeçar i akredituar i studimeve Bachelor për siguri publike për policinë dhe inspektoratin policor, shërbimin korrektues dhe atë sprovues, si dhe menaxhimin e emergjencave.
- Kurrikulat për trajnimin bazë të Policisë së Kosovës, Inspektoratit Policor të Kosovës, Doganave, Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Shërbimin Sprovues, u verifikuan dhe akredituan më 2018, me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave/Shpëtimin nga Zjarri në vitin 2019. Akademia dhe programet e saj të trajnimit bazë profesional për agjencitë e sigurisë publike morën akreditimin nga Shoqata Ndërkombëtare e Drejtorëve të Standardeve dhe Trajnimit të Zbatimit të Ligjit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (IADLEST) në maj të vitit 2018.
- Më 2014, 69 studentë filluan studimet e tyre bachelor në vitin e parë akademik, 57 në vitin e dytë, 65 në të tretin, 66 në të katërtin dhe 52 studentë në gjeneratën e pestë. Së fundmi, në vitin akademik 2019/2020, 39 studentë janë duke vijuar studimet e tyre në Fakultetin e Sigurisë Publike të AKSP-së.
- Sot, AKSP-ja ka mbi 110 kurse të ndryshme bazë, të specializuara dhe të avancuara të trajnimit në dispozicion për ofrim për të gjitha agjencitë e sigurisë publike.


PERSONELI GJATË PERIUDHËS KUR OSBE-JA USHTRONTE MANDAT EKZEKUTIV

(Fazat e Emergjencës-Tranzicionit-Transferimit)

Viti	Personeli SHSPK/QKSPEZH/AKSP	Personeli i Misionit të OSBE-së
1999	N/A	290 vendorë 260 ndërkombëtarë
2000	N/A	290 vendorë 260 ndërkombëtarë
2001	15 instruktorë të SHPK-së	246 vendorë 121 ndërkombëtarë
2002	34 instruktorë të SHPK-së	244 vendorë 96 ndërkombëtarë
2003	83 instruktorë të SHPK-së	211 vendorë 70 ndërkombëtarë
2004	89 instruktorë të SHPK-së	231 vendorë 79 ndërkombëtarë
2005	96 instruktorë të SHPK-së	220 vendorë 39 ndërkombëtarë
2006	112 instruktorë të SHPK-së	57 vendorë 30 ndërkombëtarë
2007	172 punonjës vendorë, nëpunës civilë në QKSPEZH 131 instruktorë të institucioneve të sigurisë publike	36 vendorë 19 ndërkombëtarë



KURSET DHE VIJUESHMËRIA NË AKSP



■ Nr. i vijuesve
■ Nr. i kurseve të trajnimit

Year	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Nr. i vijuesve	327	11177	15543	11631	11492	11536	11789	7975	9063	9427
Nr. i kurseve të trajnimit	6	74	347	241	473	496	328	354	336	507

2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
6980	6584	5285	4660	4263	5627	2837	2613	2571	2623	1369
338	353	315	281	277	326	171	110	171	173	51

Vërejtje: Numri i kurseve të trajnimit natyrshëm ra në 51 në vitin 2019, për shkak të prioritetit që agjencitë e sigurisë publike i dhanë trajnimeve bazë paralele në vazhdimësi të Policisë së Kosovës, Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Inspektoratit Policor të Kosovës, gjë që gjithashtu solli mungesë të hapësirave dhe konvikteve të disponueshme në AKSP.

Që nga viti 1999 e deri në vitin 2019, të gjitha kurset e trajnimit brenda AKSP-së janë ofruar në gjuhën shqipe dhe serbe.



REKOMANDIMET PËR FAZËN VIJUESE

Për të rritur vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë, e kështu edhe bashkërendimin më të mirë të trajnimeve e programeve të përbashkëta arsimore, si dhe për të shtyrë më tutje bashkëveprimin ndërmjet agjencive përkatëse që veprojnë në kuadër të AKSP, OSBE-ja rekomandon hapat vijues:

- AKSP-ja inkurajohet të themelojë një Komitet të Sigurimit të Cilësisë, i cili do të përbëhet nga drejtues dhe pjesëtarë të agjencive të sigurisë publike, si dhe Zyrës për Sigurimin e Cilësisë në AKSP.
- AKSP-ja duhet të marrë parasysh krijimin e një "Komiteti të Përbashkët Strategjik të Trajnimeve dhe Zhvillimit", organi drejtues i të cilit do të përfshinte koordinatoret e trajnimeve, ose menaxherët e nivelit të mesëm të të gjitha agjencive të sigurisë publike. Bashkërendimi i aktiviteteve midis organizatave ndërkombëtare dhe agjencive lokale, duke përfshirë donacionet, duhet të dakordohet nga mbledhjet e këtij organi drejtues.
- AKSP-ja inkurajohet të marrë në konsideratë rritjen e numrit të grave ligjëruese, instruktore e mësimdhënëse, por edhe në pozita menaxhuese e udhëheqëse brenda AKSP-së.
- AKSP-ja duhet të përpiqet të pasurojë vazhdimisht bibliotekën e saj, në formë të shtypur dhe në formate digjitale të mësimit elektronik, për të plotësuar kërkesat për hulumtime akademike.
- AKSP-së i rekomandohet të marrë parasysh digjitalizimin e kurrikulave të trajnimeve të avancuara dhe të specializuara, si dhe literaturës së studimeve Bachelor për Rend e Siguri Publike, pasi kjo i mundëson studentëve të kenë qasje në plane mësimore nga distanca.

- Kompjuterët zyrtarë në bibliotekë duhet të kenë kapacitete më të mëdha të qasjes në internet, por edhe duhen planifikuar hapësira plotësuese për seminare virtuale. Gjithashtu, sipas mundësisë, të ndërmerren hapa për të mundësuar pjesëmarrjen e studentëve në sistemet ndërkombëtare të bibliotekave elektronike.
- Meqenëse programi aktual i studimeve katërvjeçar dhe Sistemi Evropian i Transferimit dhe Akumulimit të Kredive (ECTS) me 240 kredi nuk definojnë kompetencat menaxhuese, AKSP-ja inkurajohet të marrë parasysh krijimin e një programi tre-vjeçar të nivelit baçelor me 180 ECTS, duke i mundësuar studentëve të vazhdojnë me studime pasuniversitare (master), të bazuara në politikat e zbatuara nga agjencitë e sigurisë publike.
- AKSP-ja, në bashkëpunim me institucionet e sigurisë publike, duhet të marrë parasysh edhe rishikimin e procesit të pranimit të studentëve në Fakultetin e Sigurisë Publike, ashtu që ta harmonizojnë në bazë të kriterëve e nevojave të institucioneve të sigurisë publike.
- AKSP-ja duhet të vazhdojë me vizionin e saj të krijimit të programeve të studimeve pasuniversitare për sektorin e rendit dhe sigurisë publike, ashtu siç është rekomanduar në raportin e studimit të fizibilitetit.



Police Are The PEOPLE And The PEOPLE Are The Police



WWW.AKSP-KS.NET